

Buletini i Taksave

Albania

Vendimi per miratimin dhe shperndarjen e rezultatit financiar te vitit 2009 duhet te dorezohet brenda dates 31 Korrik 2010

Shoqerite tregtare shqiptare duhet te sigurohen qe jane ne perputhje me kerkesat ligjore per te dorezuar tek Autoritetet Tatimore, deri me 31 Korrik, vendimin e asamblese se ortakeve ne lidhje me miratimin e rezultateve financiare te vitit paraardhes dhe shperndarjen e fitimit.

Per me teper, shperndarja e dividendeve te percaktuara ne kete vendim krijon detyrimin per tatimin ne burim prej 10% te shumes bruto te dividendit. Tatimi ne burim duhet te paguhet ne ditën me te afert nderjmet dates 20-te te muajit qe pason muajin e pageses se dividendit ose dates 31 Korrik. Persa kohe qe nuk eshte aplikuar per shmangien e tatimit te dyfishte, nese ka, dhe nuk eshte marre paraprakisht miratimi nga zyra e tatimeve, kompania qe shperndan dividendin duhet te mbaje 10% te tatimit ne burim, dhe me pas aksionari ka te drejte te aplikojë per rimbursim nepermjet aplikimit te marreveshjes se shmangies se tatimit te dyfishte brenda nje periudhe dy vjeçare. Per kete arsye, per te siguruar qe miratimi i marreveshjes se shmangies se tatimit te dyfishte, nese ka, ne lidhje me shperndarjen e dividendit eshte marre para afatit te detyrimit te pageses se tatimit ne burim te dividendit, shoqerite tregtare duhet te planifikojne qe te marrin vendimin e asamblese se ortakeve para dates me te fundit te lejuar me ligj, e cila eshte 30 Qershor. Shqiperia ka nenshkruar marreveshje per shmangien se tatimit te dyfishte me disa vende te BE, shumica e te cilave te mundesojne per nje norme te reduktuar ne 5%. Megjithate, ende nuk ka marreveshje te tilla ne dispozicion te aksionereve te cilet jane rezidente te vendeve si SHBA, Kanada, Britani e Madhe, dhe Gjermani.

Me poshte po paraqesim nje pershkrim te procedurave te raportimit.

Hapi 1 – Miratimi i rezultateve financiare te vitit paraardhes dhe shperndarja e rezultatit financiar

Pas dorezimit te pasqyrave financiare dhe pageses se tatimit mbi fitimin per shoqerite tregtare me 31 mars dhe brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit financiar, domethene Brenda dates 30 Qershor, asambleja e ortakeve apo organi kopetent vedimmarres i shoqerise duhet te:

- a. miratoje rezultatet financiare te vitit paraardhes;
- b. marre nje vendim ne lidhje me shperndarjen e fitimit neto te shoqerise dhe veçanerisht shumen e destinuar per:
 - i. rezerven ligjore,
 - ii. fitimin e pashperndare,
 - iii. rritjen e kapitalit nese ka, dhe
 - iv. shperndarjen e dividendeve.

Mosrespektimi i kerkesave te mesiperme sjell nje gjobe prej 25.000 leke.

Hapi 2 – Paraqitja e vendimit te ortakeve tek autoritetet tatimore

Vendimi i ortakeve duhet te dorezohet tek autoritetet tatimore brenda dates 31 Korrik.

Pervec gjobes se siperpermendur, mosrespektimi shkakton edhe nje gjobe prej 10.000 leke per çdo muaj vonese.

Hapi 3 – Pagesa e tatimit ne burim mbi dividendet

Ne rast se kompania vendos per shperndarjen e dividendeve, ne para ose ne aksione- si kapitalizim i fitimit- tatimi ne burim i dividendeve duhet te paguhet brenda dites se 20-te te muajit qe pason muajin ne te cilen pagesa e dividendeve eshte kryer, ose 31 Korrik, cilado qofte data me e afert. Prandaj, nese dividendet nuk jane shperndare deri me 31 Korrik, edhe pse vendimi i shoqerise eshte marre per shperndarjen e dividendeve, detyrimi per te bere pagesen e tatimit mbi burim lind ne ate date (31 Korrik).

Nese shoqeria tregtare vonon pagesen e tatimit ne burim ne buxhetin e shtetit, lind nje gjobe prej 5% e detyrimit tatimor te papaguar per çdo muaj vonese, gjobe e cila arrin deri ne ¼ te detyrimit tatimor, si dhe interesi qe llogaritet mbi shumen e tatimit ne burim. Mosbajta e tatimit ne burim dhe mospagesa ne buxhetin e shtetit shkakton, pervec kesaj shtese, nje penalitet prej 50% e detyrimit tatimor te papaguar.

Hapi 4 – Dorezimi i dokumenteve te nevojshme ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR)

Subjektet shqiptare duhet te paraqesin pasqyrat financiare dhe vendimin per shperndarjen e fitimit prane sporteleve te QKR-se brenda 31 Gusht-it. Deget dhe zyrat e perfaqesimit te shoqerive te huaja duhet te depozitojne tek QKR-ja edhe pasqyrat financiare vjetore te shoqerise se huaj, sipas standardeve te kerkuara ne shtetin e huaj.

Mosrespektimi shkakton nje gjobe prej 25.000 leke.

Tabela Permbledhese

PROCEDURAT	AFATET	PENALITETET
Miratimi i rezultateve financiare te vitit paraardhes dhe shperndarja e rezultatit financiar	30 Qershor	25,000 leke
Paraqitja e vendimit te ortakeve tek autoritetet tatimore	31 Korrik	10,000 leke per cdo muaj me vonese
Pagesa e tatimit ne burim mbi dividendet	Drenda dites se 20-te te muajit qe pason muajin ne te cilen pagesa e dividendeve eshte kryer, ose 31 Korrik, cilado qofte data me e afert.	Nese shoqeria tregtare vonon pagesen e tatimit ne burim ne buxhetin e shtetit, lind nje gjobe prej 5% e detyrimit tatimor te papaguar per çdo muaj vonese, gjobe e cila arrin deri ne ¼ te detyrimit tatimor, si dhe interesi qe llogaritet mbi shumen e tatimit ne burim. Mosbajta e tatimit ne burim dhe mospagesa ne buxhetin e shtetit shkakton, pervec kesaj shtese, nje penalitet prej 50% e detyrimit tatimor te papaguar.
Dorezimi i dokumenteve te nevojshme ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR)	31 Gusht	25,000 leke

Kursi i kembimit me 13 Prill 2010 sipas Reuters eshte 138.27 leke/EUR dhe 101.85 leke/USD.

Ernst & Young

Ernst & Young eshte nje lider boteror ne sherbimet e auditimit, taksave, transaksioneve, dhe konsulences. Boterisht, Stafin prej 144,000 vetash i bashkojne vlerat e perbashketa dhe dedikimi i palekundur drejt cilesise. Ne krenohemi per ndihmen qe ju ofrojme klienteve tane dhe komuniteteve te ndryshme per te arritur synimet e tyre.

Me emrin Ernst & Young ne i referohemi organizates boterore te firmave anetare te Ernst & Young Global Limited, ku cdonjera prej tyre eshte nje subject i vecante. Ernst & Young Global Limited, nje kompani e bazuar ne Britanine e Madhe, eshte e limituar nga garanci dhe si e tille nuk jep sherbime per klientet. Per me shume informacion per organizaten tone, ju lutem te vizitoni www.ey.com.

Informacioni i paraqitur ne kete buletin eshte verifikuar ne baze te njohurive dhe pikepamjeve tona me te mira ne momentin e daljes ne shtyp. Ju lutem kini parasysh se informacioni ne kete buletin nuk duhet te perdoret si konsulence per taksat dhe nuk mund te zevendesoje keshillimin ne konsulentet tane te taksave.

Per me shume informacion, ju lutemi te kontaktoni:

Alexandros Karakitis
alexandros.karakitis@al.ey.com

Dorina Tila
dorina.tila@al.ey.com

© 2010 Ernst & Young Albania
Te gjitha te drejtat te rezervuara.

Ky publikim permban informacion ne formen e nje permbledhjeje, dhe sherben vetem si nje udhezim i pergjithshem. Ky publikim nuk ka per qellim te zevendesojte studimin me te detajuar apo opinionin profesional. Jo vetem Ernst & Young Albania, por asnje anetar tjetër i organizates boterore te Ernst & Young, nuk merr persiper humbje te shkaktuara nga veprimi apo mos-veprimi i cdo personi si pasoje e materialit te publikuar ne kete buletin. Per cdo ceshtje te vecante, ju lutem referojuni konsulentit perkates.